

Zotërimi Doktrinor për Librin e Mormonit: Vlerësimi 1

1 NEFI 3:7 DERI TE MOSIA 18:8-10

Referencat e zotërimit doktrinor

Për pyetjet 1–3, shkruaj shkronjën e referencës përkatëse në vendin bosh pranë çdo fraze. Të lutem, mos i përdor shkrimet e tua të shenjta për këtë pjesë të vlerësimit.

Frazat Kyç	Referencat nga Shkrimet e Shenjta
____ 1. "At[a] që zbatojnë urdhërimet e Perëndisë . . . janë të bekuar në të gjitha gjërat."	a. 1 Nefi 3:7 b. 2 Nefi 2:25
____ 2. "Unë do të shkoj dhe do të bëj gjërat që Zoti ka urdhëruar."	c. 2 Nefi 2:27 d. Mosia 2:41
____ 3. "Adami ra që njerëzit të mund të jenë; dhe njerëzit janë, që ata të mund të kenë gëzim."	e. Mosia 3:19

Frazat kyç të shkrimit të shenjtë

Për pyetjet 4–6, plotëso fjalët që mungojnë në frazat kyç të shkrimit të shenjtë për zotërimin doktrinor. Të lutem, mos i përdor shkrimet e tua të shenjta për këtë pjesë të vlerësimit.

4. "Kur jeni në _____ e bashkë _____ tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e _____ tuaj" (Mosia 2:17).
5. "Zhv[ishe] njeriun _____ dhe . . . bëh[u] një _____ nëpërmjet _____ së Krishtit Zot" (Mosia 3:19).
6. "_____ në emrin e Zotit, si një _____ . . . që ju keni hyrë në një _____ me të" (Mosia 18:8–10).

Zbatimi në situatat nga jeta reale

Mund t'i përdorësh shkrimet e tua të shenjta për pjesën e mbetur të vlerësimit.

Për pyetjet 7–8, përcakto një ose më shumë fragmente të zotërimit doktrinor që mund ta ndihmojnë dikë në situatat vijuese, dhe shpjego se si e vërteta ose të vërtetat në fragment/e mund të ndihmojnë. Më pas ndiqi udhëzimet për pyetjen 9.

7. Një i ri duhet të marrë një vendim të rëndësishëm që mund të ndikojë shumë në të ardhmen e tij. Ai është në ankth dhe i pasigurt se çfarë zgjedhje të bëjë.

8. Një e re jeton në një situatë që ajo e ndien se ia bën shumë të vështirë që t'i zbatojë urdhërimet e Perëndisë. Ajo dëshiron të jetë e bindur, por kjo duket shumë e vështirë në rrethanat e saj.

9. Zgjidhe cilindo prej 12 fragmenteve të zotërimit doktrinor nga 1 Nefi deri te Mosia, si dhe trego një situatë ku të vërtetat që jepen mësim në atë fragment, mund ta ndihmojnë një adoleshent në jetën e tij ose të saj.

Parimet e marrjes së njohurisë shpirtërore

Për pyetjet 10–11, demonstro njohurinë dhe aftësinë tënde për t'i përdorur parimet e marrjes së njohurisë shpirtërore.

10. Shpjegoji shkurtimisht tre parimet vijuese të marrjes së njohurisë shpirtërore me fjalët e tua.

a. Vepro me besim.

b. Shqyrtoji konceptet dhe pyetjet me një këndvështrim të përjetshëm.

c. Kërko kuptueshmëri të mëtejshme nëpërmjet burimeve të caktuara në mënyrë hyjnore.

11. Një mike po bën pyetjen se përse disa gjëra që i janë mësuar në kohët e fundit në shkollë, duket se e kundërshtojnë atë që Perëndia ka dhënë mësim nëpërmjet shkrimeve të shenjta dhe profetëve bashkëkohorë. Përgjigju për pyetjet vijuese:

a. Çfarë gjërash të veçanta mund të bëjë ajo për të vepruar me besim?

b. Si mund ta ndihmojë atë të parit e kësaj situatë me një këndvështrim të përjetshëm?

- c. Fragmentet e zotërimit doktrinor janë shembuj të burimeve të caktuara në mënyrë hyjnore. Cili/ët fragment/e i/të zotërimit doktrinor nga 1 Nefi deri te Mosia mund ta ndihmojë/në miken tënde? Në ç' mënyrë?

Ndikimi në jetën tënde

12. Cili është një fragment i zotërimit doktrinor që e studiove këtë semestër, i cili ka ndikuar te ti? Si ka ndikuar te ti? Çfarë të mëson ky fragment rreth Atit Qjellor dhe Jezu Krishtit?
